



lalzi forest
mobile: +355692040605
e-mail: info@lalzi.al
adresa: Fshati Lalëz, Durrës

**Akt Themelimi
i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
“lalzi forest” sh.p.k**

**Neni 1
Formimi**

Sot më dt. 28/01/2025 themeluesit që firmosin më poshtë:

- z. Sokol Luzi, shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar, i lindur në Tiranë, Shqipëri, më dt. 12.06.1987, dhe banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal I70612068P;
- z. Malsed Dauti, shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar, i lindur në Burrel, Shqipëri, më dt. 29.03.1982, dhe banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal I20329077Q;
- z. Endi Sinemati, shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar, i lindur në Tiranë, Shqipëri, më dt. 07.12.1986, dhe banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal I61207035D;

Në bazë të Ligjit Nr. 9901, Dt.14.04.2008, “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” si dhe të Ligjit Nr. 9723, Dt.03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit”, themelojnë me vullnet të plotë dhe të lirë shoqërinë tregëtare me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin “lalzi forest” sh.p.k.

**Neni 2
Selia e shoqërisë**

Selia e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “lalzi forest” sh.p.k, është në fshatin Lalëz, ZK 2375, Nr. Pasurie 121/13, Njësia Administrative Ishëm, Durrës, Shqipëri.

**Neni 3
Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “lalzi forest” sh.p.k, është pa afat nga momenti i regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.



lalzi forest
mobile: +355692040605
e-mail: info@lalzi.al
adresa: Fshati Lalëz, Durrës

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “lalzi forest” sh.p.k është:

- Agroturizëm për ofrim ushqimi dhe ambiente për qëllime pushimi, bujtina, kamping, hoteleri dhe akomodim fjetje, veprimtari turistike (kënde shlodhëse dhe argëtimi, mjedise sportive, etj). Ofrimi i shërbimeve në fushën e agroturizmit dhe turizmit. Degustime dhe shitje në nivel të konsumit personal, të artikujve bujqësore e blegtorale, arroreve, frutoreve, agrumeve, drithrat, ullinjve, vreshtave, mjaltit, vajit të ullirit, verës dhe pijeve të tjera alkoolike dhe reçelname. Si dhe çdo aktivitet tjetër tregtar dhe financiar që i shërben realizimit të objektivit të saj.

Neni 5

Kapitali i shoqërisë

Kapitali fillestar i shoqërisë “lalzi forest” sh.p.k është 100.000 lekë dhe i ndarë në 3 kuota me kontributin e ortakëve si më poshtë:

- Një kuotë për z. Sokol Luzi, në masën 34 % (Tridhjetë e katër përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë
- Një kuotë për z. Malsed Dauti, në masën 33 % (Tridhjetë e tre përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë
- Një kuotë z. Endi Sinemati, në masën 33% (Tridhjetë e tre përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë

Kapitali fillestar është i nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga ortakët themelues, ai mund të ndryshojë sipas vendimit që mund të marrin ortakët, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

Neni 6

Organet e shoqërisë dhe Asambleja

Organet drejtuese të shoqërisë “lalzi forest” sh.p.k janë:

- Asambleja e Ortakëve, organi më i lartë vendim-marrës
- Administrator është Znj. Elena Bashi, shtetase shqiptare me zotësi të plotë për të vepruar, i lindur në Athinë, Greqi më dt. 06.10.1991, dhe banuese në Tiranë Shqipëri, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal J16006055M. Kohëzgjatja e administratorit është për një periudhë 5 vjeçare, deri më dt. 27.01.2030.



lalzi forest
mobile: +355692040605
e-mail: info@lalzi.al
adresa: Fshati Lalëz, Durrës

Neni 7 Organizimi i shoqërisë

Organizimi i shoqërisë, marrëdhëniet me persona fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, shprehen në statusin e shoqërisë që së bashku me aktin themelimit janë dokumentacioni bazë i veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e marrëdhënieve në këtë shoqëri.

Neni 8 Legjislacioni

Në lidhje me veprimtarinë e saj, shoqëria do ta zhvillojë në përputhje me legjislacionin që aplikohet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 9

Të gjitha mosmarrëveshjet me persona fizikë ose juridikë si dhe me organet shtetërore zgjidhen me mirëkuptim, me anë të dispozitave të këtij akti, statuti dhe legjislacionit shqiptar dhe kur këto mjete nuk japin rezultat atëherë zgjidhen me gjykatë.

Ky akt themelimi hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "lalzi forest" në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dhe në këtë ditë shoqëria "lalzi forest" përfiton statusin e personit juridik.

Ortakët e Shoqërisë

Sokol LUZI

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Sokol LUZI', written over a horizontal line.

Malsed DAUTI

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Malsed DAUTI', written over a horizontal line. Below the signature is a large, stylized flourish.

Endi SINEMATI

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Endi SINEMATI', written over a horizontal line. Below the signature is a large, stylized flourish.